



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:009341

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876658

P.nr.70/2020

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović - Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në lëndën penale ndaj të pandehurit R.T nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.3029/19, të datës 20.01.2020, për vepër penale „Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET AKTAKUZA** e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr. 3029/19 të datës 20.01.2020.
- II. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit R.F, për shkak të veprës penale „Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-, për shkak të ***parashkrimit absolut të ndjekjes penale.***
- III.** Përfaqësuesi palës së dëmtuar – KEDS-it, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të pandehurit R.T nga Peja, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.3029/19, me datë 21.01.2020, për veprë penale „Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin P.nr.70/2020, të datës 03.04.2023, e ka kthyer në plotësim aktakuzën PP/II.nr. 3029/19, e datës 21.01.2020, me kërkesë që aktakuza brenda afatit prej 21 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të plotësohet sipas vërejtjeve të theksuara në aktvendim.

Prokuroria Themelore në Pejë edhe përkundër kërkesës së gjykatës dhe paralajmërimit për pasojat e mosveprimit, nuk ka vepruar sipas aktvendimit brenda afatit të caktuar. Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 441 par.4 të KPRK-së, me aktvendimin P.nr.70/20 dt.06.06.2023, e hedh aktakuzën PP/II.nr.3029/19, kundër të pandehurit R.T për shkak të veprës penale „Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, të ushtruar me datë 21.01.2020, si të parregullt.

Kundër aktvendimit *P.nr.70/20, i dt. 06.06.2023*, Prokuroria Themelore në Pejë me datë 12.06.2023 ka ushtruar ankesë për arsye të shkeljes së dispozitave të procedurës penale nga neni 415 par.1 nën par.1.2 të KPPRK-së.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, me aktvendim *PN.ND.nr.780/2023 dt. 25.04.2024*, ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë ashtu që anuluar aktvendimin e Gjykatës se shkallës së parë P.nr.70/20 të dt.06.06.2023, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve ” nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe çështjen ia kthej gjykatës në procedim të mëtutjeshëm.

Sipas aktakuzës dyshohet se vepra penale është kryer nga periudha e papërcaktuar kohore deri me datë *12.04.2018*, ku në atë kohë ka qenë në fuqi Kodi Penal (Kodi nr. 04/L-082), sipas të cilit në nenin 320 par. 1 të KPRK-së (nr.04/L-082) „Vjedhja e shërbimeve komunale” përcaktohet: “Kushdo që merr, përdor, devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.

Meqenëse sipas nenit 320 të Kodit penal (Kodi nr. 04/L-082) parashihet dënimi me gjobë ose/dhe me burgim deri në tre (3) vjet, e po ashtu sipas nenit 314 të Kodit penal (Kodi nr. 06/L-074), për veprën penale „Vjedhja e shërbimeve” parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, gjykata gjen se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Dispozita e nenit 106 par.1 nën paragrafit 1.5 të KPK-së (Kodi nr.04/L-082) thotë se *ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet, nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim.*

Dispozita e nenit 107 par.1 i KPP-së thotë se *afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale, e sipas përshkrimit faktik të veprës penale „Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, koha e kryerjes se veprës penale është data 12.04.2018.*

Bazuar në nenin 107 par.8 të KPRK-së, *ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit (ndalesë absolute e ndjekjes penale), në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vite, andaj sipas aktakuzës dyfishi i kohës së parashkrimit lidhur me veprën penale „Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, është arritur me datë 12.04.2024.*

Gjykata ka aplikuar Kodin nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, meqenëse vepra penale është kryer në kohën kur ishte në fuqi Kodi i lartcekur, edhe pse e ka krahasuar edhe me Kodin nr. 06/L-074 Penal i cili është në fuqi, mirëpo gjeti se kodi i mëparshëm është më i favorshëm për të pandehurin sa i përketë parashkrimit.

Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e bazoi në nenin 462 par. 3 të KPP-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 par.1 të KPP-së.

Andaj, bazuar në të cekurat më lartë në kuptim të nenit 106 par.1 nën par. 1.5 dhe 107 par.1 dhe par.8 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, nenit 357 par.1 nënpar.1 .3 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI PENAL
P.nr.70/2020, me dt. 12.06.2024.

Bashkëpunëtore profesionale

Gylaj Nepola

Gjyqtare e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.